



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 47/19
Prishtinë, më 20.03.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Ali Lajçi dhe Arbërie Nagavci, Dardan Molliqaj, Blerim Kuqi dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontic, Mërgim Lushtaku dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Blerim Dina - Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (tutje OSHP), Agim Sheqiri - Zyrtar Kryesor Financiar në OSHP.

Pjesëmarrës tjerë: Edon Kurtishi – Këshilltar USAID - Team, Ruzhdi Zeqiri - Udhëheqës Kompetent, Albulena Avdiu – Gazetare nga Ekonomia Sot, Dardane Neziri – Gazetare nga Koha Ditore, Liridona Vitia - Gazetare nga Radio Kosova, Avni Zogiani – Këshilltar në Lëvizjen Vetëvendosje, Blendon Arifi – Praktikant, Edison Sylja – Praktikant, Semra Citaku – Këshilltare për Ekonomi në Ambasadën Britanike në Prishtinë.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari i Komisionit).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të Komisionit, dt. 27.02.2019 dhe 06.03.2019;**
- 3. Votimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018;**
- 4. Votimi për Projektligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018;**
- 6. Diskutim lidhur me Shkresën nr.198/19 , dt. 26.02.2019 e Kryetarit dhe dy anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të dërguar në Kuvendin e Kosovës;**
- 7. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie;**

8. **Caktimi i Grupit Punues për hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022;**
9. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari i Komisionit: Konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të Komisionit, dt. 27.02.2019 dhe 06.03.2019**

Kryetari i Komisionit: Konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi, procesverbalet nga mbledhjet e mbajtur të Komisionit, dt. 27.02.2019 dhe 06.03.2019, pa vërejtje.

3. **Votimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018;**

Kryetari i Komisionit: Sqaroi se në mbledhjen e fundit kemi shqyrtuar Raportin vjetor të shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2018, por që nuk kemi pasur korum për votim.

Arbërie Nagavci: Theksoi se meqë në mbledhjen kur kemi shqyrtuar Raportin, kemi kërkuar nga Sekretari i Kuvendit, të na sjell dokumente dhe informacione shtesë, dhe ato deri më tani nuk janë dërguar, propozojë që të shtyjme këtë pikë për votim, deri sa ti marrim dokumentet dhe informacionet e kërkuara.

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që votimi i Raportit vjetor të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2018, të shtyhet për në një mbledhje tjetër të komisionit. Njëkohësisht, do të kërkohet nga Sekretari që ti dërgojë Komisionit informatat e kërkuara.

4. **Votimi për Projektligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Kryetari i Komisionit: Sqaroi se në mbledhjen e fundit kemi shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, por që nuk kemi pasur korum për votim. Projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore. Propozojë që ta votojmë dhe ta procedojmë tutje rekomandimin.

Në bazë të propozimit, Kryetari i Komisionit, konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe amendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. **Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018**

Kryetari: I'a kaloi fjalën, Kryetarit të OSHP-së Blerim Dina për ta paraqitur dhe arsyetuar raportin vjetor 2018.

Blerim Dina: Në bazë të të dhënave të paraqitura në raportin vjetor të OSHP-së, për vitin 2018 janë gjithsej 763 ankesa, ku të gjitha janë shqyrtuar. Janë aprovuar gjithsej 250 dhe janë rivlerësuar 369. Në mesin e tyre 27 tërheqje nga operatorët ekonomik, 22 urdhëresa për autoritetet kontraktuese dhe 4 gjoba, 3 anulime të aktiviteteve, 6 urdhëresa të cilave u është dhënë hapësira e përmirësimit.

Kryetari: Bëri disa pyetje për Kryetarin e OSHP-së, si në vijim:

Në raport ceket se në 396 raste është bërë rivlerësim i ofertave, a ka raste që Autoritetit Kontraktues edhe pas rivlerësimit ta merr tenderin i njëjti Operator Ekonomik dhe nëse ka raste a keni ndërmarrë ndonjë masë ju si OSHP ndaj autoritetit në fjalë, përkatësisht zyrtarëve përgjegjës?

Në bazë të të dhënave të raportit, OSHP ka shqyrtuar 19 urdhëresa ndaj Autoriteteve Kontraktues për shkak të mosrespektimit të vendimeve të Paneleve shqyrtuese për anulimin e aktiviteteve të prokurimit. A janë respektuar apo përmbushur urdhëresat e OSHP-së nga Autoritetet Kontraktuese në fjalë?

Në tabelën krahasuese, përmendet edhe kategori “Anulimi i anulimit”. A është fjala për rastet kur OSHP ka anuluar një ankesë dhe operatori ekonomik prapë është ankuar dhe si rezultat OSHP, ka anuluar lëndën që njëherë vetëm është anuluar?

Numri i ankesave në vitin 2018 është rritur për 210 krahasuar me vitin 2017. Në bazë të vlerësimeve të OSHP-së, a është kjo si rezultat i shkeljes së mundshme ligjore në procesin e prokurimit apo është rezultat i vetëdijësimit të operatoreve ekonomike për shfrytëzimin e të drejtës së ankesës?

Ajo që është duket me interes për sqarime shtesë është numri i madh i ankesave ndaj Ministrisë së Mbrojtjes, gjithsej 21 ankesa?

OSHP ka raportuar janë shqyrtuar 763 ankesa dhe janë dhënë vetëm 4 gjoba. Cili është roli OSHP-së ndaj AK për moszbatimin e gjobave. A është duke u përdorur mundësia e ekzekutimit të mjeteve përmes përmbartësive dhe a janë ekzekutuar mjetet nga shqiptimi i gjobave?

Cili është niveli i bashkëpunimit në mes të OSHP-së dhe KRPP-së në procesin e prokurimit. Specifikisht, në rastet kur OSHP vërteton shkeljet në procesin e prokurimit publik janë të qëllimshme nga zyrtarët e prokurimit dhe komisionet vlerësuese, a i raporton këto raste tek KRPP, me qëllim të shqyrtimit të marrjes së licencës ndaj zyrtarëve të prokurimit?

Blerim Dina: Sqaroi se prej 396 ankesave për rivlerësimin e gabuar të ofertave janë zbatuar gjitha urdhëresat e OSHP-së. Nga 22 urdhëresa autoritetet kontraktuese kanë zbatuar. Janë shqyrtuar 19 urdhëresa për shkak të mosrespektimit të kërkesave nga autoritetet kontraktuese, mirëpo nuk ka pasur nevojë për ndërhyrjen e organeve të rendit.

Rreth anulim-anulimit janë lajmëruar tri aktivitete të autoriteteve të prokurimit raste kur operatori ekonomik ka qenë i pakënaqur dhe ka paraqitur ankesë në OSHP dhe kjo e fundit ka aprovuar urdhëresën e autoriteteve kontraktuese e jo të operatorit ekonomik. Rritja e numrit të ankesave deri në 210 gjithsej, vërejtje si shkak i vetëdijësimit të operatorëve ekonomik. Në Ministrinë e Mbrojtjes 21 ankesa, nuk kemi bërë ndonjë analizë për këtë numër të ankesave, në mungesë të stafit të mjaftueshëm për të bërë analiza të tilla.

Anulimi i anulimit është kur operatori ekonomik është i pakënaqur me anulimin e tenderit të autoritetit kontraktues dhe ka paraqitur ankesë në OSHP kundër anulimit.

Mbi rolin e OSHP-së në autoritetet kontraktuese rreth moszbatimit të gjobave, rastet kur nuk i janë paguar, OSHP ka bërë kërkesë Thesarit që të zbatohen, mirëpo nuk janë ekzekutuar pasiqë Thesari thekson se nuk ka bazë ligjore ta bëjë atë. Tani jemi në fazën e ekzekutimit të gjobave përmes përmbartësive privat. Sa i përket nivelit të bashkëpunimit me KRPP-në, raporte janë të mira, dhe kemi pasur edhe një rast që si rezultat i rekomandimit të OSHP-së ndaj zyrtarëve të papërgjegjshëm prokurimit, KRPP ka marrë licencën dhe një rast kur i është bërë vërejtja me shkrim ndaj një zyrtari të prokurimit.

Blerim Kuçi: Theksoi se raportit vjetor është dashur të bashkangjiten rekomandimet e auditorit të përgjithshëm për 2017 dhe masat apo planin e veprimit për implementimin e tyre. Më intereson të dijë

brenda çfarë afatesh OSHP bënë shqyrtimin e ankesave? Kjo pasiqë afatet e gjatë në shqyrtimin e tyre po kanë ndikim në realizimin e buxhetit nga autoritetet kontraktuese, konkretisht në realizimin e projekteve kapitale dhe si rezultat buxheti nuk po shpenzohet në mënyrë efikase.

Blerim Dina: OSHP si organ administrativ ka bërë shqyrtimin e ankesave brenda afatit ligjorë prej 65 ditësh, afati me i gjatë për rastet e rënda deri në 90 ditë. Janë organizuar edhe tryeza në të cilat janë realizuar diskutime bashkarisht, ata u bindën për gabimet e tyre dhe në të ardhmen kanë premtu zbatimin e drejtë të ligjit. Autoritet kontraktuese kanë një mundësi se mund të bëjnë kërkesë për rishqyrtim duke vënë në dijeni përmirësimin e gabimit.

Agim Sheqiri: Sqaroi se plani për implementimin e rekomandimeve të auditimit është dërguar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Dardan Molliqaj: Si grup parlamentar do të nisim ndryshimin e ligjit të prokurimit, sepse ligji është burimi i së keqes në këtë fushë. OSHP është shëndërruar si një ndër organet më të korruptuar në Kosovë. Mungesa e efikasitetit fillon nga niveli prokurorimit bazë. Operatorët ekonomik shfrytëzojnë OSHP-në dhe kjo ndikon në efikasitetin e zhvillimit të procesit të prokurimit. Raste në Komunën e Prishtinës, Kamenicës dhe ministri të ndryshme.

Blerim Dina: Sa i përket komunës së Prishtinës nëse jeni në dijeni për vendimet që ka marr OSHP ndaj autoriteteve kontraktuese duhet keni prova se nëse ka pasur shkelje ose marrdhënie me ministritë kërkuese. Me shumë kompetencë gjitha vendimet bazohen në ligj.

Dardan Molliqaj: Unë e theksova se mungesa e efikasitetit janë komunat dhe institucionet tjera dhe për shkak të problemeve dhe ngecjeve në shkallën e parë të prokurimit në autoritetet kontraktuese. Bindja është se OSHP shërben me i shty interesat e kompanive të ndryshme. Sa më e lehtë shkalla e prokurimit bie numri korrupsionit, prandaj me ndryshimet e ligjit do të duhej rirregulluar OSHP-ja.

Arbërie Nagavci: Nga të dhënat e raportuara, shifet se 19 urdhëresa janë shqiptuar për shkak të mosrespektimit të ligjit të cilat kanë të bëjnë me institucionet publike dhe prej tyre 3 urdhëresa për Korporatën Energjetike të Kosovës. A jeni në dijeni se çka ka ndodhur me këto urdhëresa dhe për rastet e shqyrtuara e të aprovuara, anuluar a jeni në dijeni rreth shqyrtimit të tyre në gjykatë? Për të cilat urdhëresa, palët e caktuara theksojnë se ju nuk i keni përmbushur në disa organizata. Shembull dy kontrata prej 5 milion eurosh dhe kompani të cilat kanë fituar tender por nuk kanë pasur të tilla ose kur operatorët ekonomik raportet financiare nuk i kanë dorëzuar të tilla sipas fletës së të dhënave. Sa janë raste të tilla dhe komenti për këto raste kur keni kaluar ankesat tutj?

Blerim Dina: OSHP ka pasur ankesa në gjykatë kur në një kohë nuk ka ekzistuar bordi dhe ky bord ka bërë konkluzion dhe nuk i ka shqyrtu. Tri ankesa nga 763 kaluan në gjykatë.

Naser Osmani: Bëri dy pyetje: a po bëhet projektimi i kërkesave të proceduarve një burimore dhe a ka nga hetuesia mbikëqyrje të kërkesave para shqyrtimit?

Blerim Dina: Ligji parasheh që autoritetet kontraktuese mund të shfrytëzojnë edhe procedura një burimore dhe para aplikimit ato lajmërojnë KRPP-në. Ai theksoi se nuk ka pasur ndonjë ankesë lidhur me këtë procedurë. Lidhur me pyetjen e dytë ai tregoi se njësitet e hetuesisë ka raste kur mbikëqyrin kërkesat para shqyrtimit.

Safete Hadergjonaj: Theksoi se ka analizuar raportin dhe nuk ka vërejtur ndonjë risi. Përveç paraqitjes së të dhënave formale që kërkohen me ligj, nuk kemi të dhëna tjera analitike që e bëjnë raportin më përmbajtësor. Ky organ është si Gjykatë e Tenderëve, prandaj pasqyrimi i punë duhet të jetë më gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore.

Mendohet se nëse vihet në binarë ky institucion do të rrjedhin më lehtë çështjet. Shofim se janë 27 raste të cilat kanë tërhequr ankesat e tyre. Pse ka ardhur kjo tërheqje? Nga 396 lëndë që janë kthyer në rivlerësim, çka ndodh me to a janë përkrahur nga organet kontraktuese, a ka pasur vërejtje?

Çka ka ndodhur me vërejtjet që u kemi dhënë organeve kontraktuese për anulim të aktivitetit prokurorimit. Sa janë marrë parasysh urdhëresat e shqyrtuara?

Blerim Dina: Sa i përket pyetjes së parë, këtë vit do kemi plus 7 pozita si përforsim i stafit dhe do të kemi mundësi për punë më shumë dhe si rrjedhojë raportime më gjithëpërfshirëse. Për tërheqjen e operatorve ekonomik nuk kemi bërë ndonjë hetim se pse ose çka po ndodh. Por ne e aprovojmë tërheqjen e operatorëve ekonomik.

Në pyetjen e dytë, pasi që janë kthyer lëndët në rivlerësim nga autoritetet kontraktuese prej 22 urdhëresave atëherë kanë zbatuar vendimet tona.

Pas përfundimit të votimit dhe pas zhvillimit të procesit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni nuk pati korum për vendimmarrje, dhe votimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018, shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit.

5. Diskutim lidhur me Shkresën nr.198/19 , dt. 26.02.2019 e Kryetarit dhe dy anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të dërguar në Kuvendin e Kosovës

Kryetari i Komisioni: Z.Dinaj ka dërguar një letër te kryetari i Kuvendit e cila është vendosur në rend të ditës për diskutim. Ju keni shkruar se OPSH-ja po përballet me presione nga policia dhe prokuroria, presione këto që po pengojnë institucionet tuaja në ushtrimin e kompetencave dhe në çdo vendim. Ju keni thënë se policia e Kosovës kërkon dosjen e tenderëve dhe në baza ditore policia endet në zyrat e OPSH-së. Me çfarë presioni përballeti dhe të jeni sa më të hapur në lidhje me hetuesinë dhe policinë.

Blerim Dina: Bordi jonë është zgjedhur për zbatimin e rasteve në bazë të ligjit dhe është i pavarur në marrjen e vendimeve. Çdo palë që është e pakënaqur me vendimet e OPSH-së e ka këshillën juridik që mund të ankohet në gjykatë. Rruga ligjore parashohin se nëse ka shqetësime nga operatorët ekonomik të drejtohen në OSHP, nëse shqetësimi vie nga autoritetet kontraktuese të drejtohen në gjykatë. Ne kemi sqaruar në letër se po pengohemi në punën tonë në thirrjet dhe kërkesat e policisë dhe prokurorisë, që janë të ndryshme dhe shpesh herë pa paralajmërim.

Kryetari: Pyeti për motivet e policisë së hetuesisë, pse ndodh ky presion?

Blerim Dina: Ata e dinë më mirë pse ndodh kjo, por ne po kemi presion në punë më ndërhyrjet e shpeshta në proces të trajtimit të lëndëve.

Arbërie Nagavci: Shqetësuese me pa një letër të tillë nga ky organ i rëndësishëm dhe presionet që marrin nga organet publike. A keni ndonjë rast specifik që jeni marrë më shumë në pyetje apo ndodh në vazhdimësi për çdo vendim që ju merrni?

Blerim Dina: Theksoi se kjo ndodh në vazhdimësi nëse çdo qytetar shkon në polici dhe lajmërohet se ka shkelje në OSHP.

Arbërie Nagavci: A keni biseduar me dikënd për prova apo konsideroni se kjo ju bëhet me qëllim?

Blerim Dina: Unë kam pasur takim me drejtorin e policisë dhe ai ka thënë se vinë me urdhër të prokurorit por se ne nuk i kemi parë, vetëm kuptojmë se jemi në hetuesi.

Blerim Kuçi: Ajo letër që keni dërguar më është dukur më absurdja ndonjëherë. Duhet të shikojmë të gjitha ligjet, por jeni autoriteti i pavarur dhe në qoftëse organet e tjera përzihen në marrjen e vendimeve atëherë çështjet duhet të jenë kriminale por jo rreth e marrjes së vendimeve. Ju keni mekanizma tjerë për mospërzirjen dhe ruajtjen e autoritetit tuaj. Letra edhe mund të jetë një lloje amenstie për shkeljet e ndodhura në vetë OSHP-në!

Naser Osmani: Letra është shqetësuese. Konsideroj se asnjë institucion nuk mundet me ndërhy para një vendimi të marrë nga ana OSHP-së, vetëm për ankesa. Unë mendoj se letra duhet lexuar para deputetëve në seancë, në emër të komisionit.

Blerim Kuçi: Unë mendoj se ne si komision funksional, mund ta krijojmë një grup punues me pa zbatimin e ligjit të OSHP-së dhe shqetësimet e ngritura dhe deri në cilën pikë ka ndërhyrje në punën e institucionit.

Safete Hadergjonaj: Unë e kam pasur letrën me kohë përmes email adresës. Ne duhet ta dijmë sa a ka ndodhur ndërhyrja për ndonjë rast apo në të gjitha rastet? Nuk e di arsyen e ndërhyrjes, është mirë të kemi informata më të detalizuara, nevojitet dëshmi dhe verifikim në çështjet e pretenduara. Pra, nuk mund ta lexojmë letrën pa i ditë informatat e detalizuara. Nuk pajtohem që të lexojmë letrën në emër të komisionit.

Enver Hoti: Theksoi se është shqetësuese në jeni të rrezikuar dhe ndërhyrje në punën tuaj si OSHP. Mirëpo duhet potencuar se në OSHP, nuk ka shkuar puna mirë. Kemi ankesa për veprimet që i shkaktoni edhe nga institucionet e organizatat tjera. Është e nevojshme me krijue një grup punues për të diskutuar çështjet e ngritura.

Ali Lajçi: A keni shqyrtuar të drejtën ligjore që me vepru në bazë të ligjit dhe procedurave apo vetëm ju ka mbetur konstatimi në baza verbale?

Kryetari: Kjo çështje kërkon trajtim por, duhet pasur kujdes mes fijes së hollë që ndan politikën prej intervenimit gjyqësor sepse jo ndoshta të gjitha rastet janë të qëllimshme, aty nuk guxojmë të demotivojmë as policinë as gjyqësinë për punën që e ka.

Arbërie Nagavci: Në pyetjen se a keni biseduar me komandantin e policisë, ju thatë se u është dhënë atyre urdhëri nga prokurori, por a u është prezantuar ndonjëherë dokument nga policët për ardhjen e tyre?

Blerim Dina: Policia nuk na prezantojnë dokumente, madje as ftesa nuk na japin. Tani janë tri njësi: Njësia rajonale për kërkime, Drejtoria për Krime Ekonomike në qendër dhe Task forca. Këto tri njësi kanë bërë vajtje-ardhje. Rasti në procedurë akoma mbetet në procedurë dhe tre anëtarët e bordit kanë qenë për të marrë shpjegime në gjyqësi dhe prokurori për vendimet që janë marrë. Shkresën e kemi konsideruar si lloj ankese të cilën ia kemi dërguar Kryetarit të Kuvendit me qëllim që t'ua përcjellë edhe komisioneve tjera. Letrën e kemi dërguar të Këshilli Prokuritorial, kryetarët e gjykatave dhe të gjitha institucionet që merren me zbatimin e ligjit.

Kryetari: Kemi dy alternativa apo propozime: që në pjesë të arsyetimit të rekomandimit të Komisionit për Raportin e punës së OSHP-së në seancë të ngritim edhe çështjen e letrës dhe ndikimit politik në punën e OSHP-së. Për ta bërë këtë gjë duhet të votojmë raportin e punës paraprakisht. Çështja e dytë që ka të bëjë me letrën të ngritet në seancë individualisht si deputetë dhe grupe parlamentare.

Blerim Kuçi: Kjo letër nuk ka qenë pjesë e raportit dhe është dashur të raportohet që të mund të ngritet së bashku me raportin vjetor 2018. Nëse rastet e ngritura në letër janë të vitit 2018 është dashur të paraqitet në raport.

Pas përfundimit të votimit dhe pas zhvillimit të procesit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni nuk pati korum për vendimmarrje për nxjerrjen e rekomandimit për Kuvendin për miratimin e Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2018, dhe bashkangjijtjen e shkresës nr.198/19 , dt. 26.02.2019 së Kryetarit dhe dy anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si pjesë e rekomandimit të komisionit.

6. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie

Kryetari: Kemi pranuar një kërkesë nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e pagës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të kësaj agjencie. Unë mendoj që ne nuk jemi sot të gatshëm të nxjerrim ndonjë rekomandim për këtë çështje dhe propozoj që ta shtyjmë në një mbledhje tjetër.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që të shtyhet i Kërkesës së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie, per një mbledhje tjetër të komisionit.

7. Caktimi i Grupit Punues për hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022

Kryetari i Komisionit: Propozoj që Grupi Punues për shqyrtimin e KASH-it të Kuvendit 2020-2022, të jetë i njëjti si vitin e kaluar.

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni njëzëri caktoi Grupin Punues për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku